



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada –

Government

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i
Sporta / Ministry of Culture, Youth and Sports**

Prishtinë, Maj 2024

**THIRRJE PËR ORGANIZATA JO-QEVERITARE PËR ZBATIMIN 3-VJEÇAR TË
PROGRAMIT “REHABILITIMI PËR TË RINJTË”**

Në Strategjinë Shtetërore për Rininë 2024-2032 janë paraparë një varg aktivitete nga edukimi dhe promovimi shëndetësor, si dhe nga rehabilitimi shëndetësor i të rinjve. Këto aktivitete janë dokumentuar nga të gjeturat e vlerësimit të zbatimit të Strategjisë për Rini 2019-2023, ku ndër të tjera ishte edhe e gjetura: trajtimi i shëndetit mendor, siguria, mbrojtja e mjedisit, parandalimi i dhunës fizike dhe psikike, etj.

Në kuadër të sfidave aktuale lidhur me shëndetin e të rinjve është gjetur se duhet të përmirësohen shërbimet për parandalimin dhe adresimin e disa problemeve aktuale të të rinjve që ndërlidhen me shëndetin fizik dhe mendor, dukuritë që cenojnë sigurinë e tyre, siç është bullizimi (ngacmimi) fizik dhe verbal, e po ashtu edhe ngacmimet seksuale. Sipas të gjeturave të vlerësimit po ashtu, të rinjtë ndjehen shumë më të sigurt në lagje se sa në shkollë.

Sfidë shtesë, e që ndikojnë drejtpërdrejtë në shëndetin e të rinjve është edhe siguria kibernetike e të rinjve, ofrimi i shërbimeve për të rinjtë e marginalizuar, si të rinjtë e zonave rurale, parandalimi i dhunës së shprehur ndaj grave dhe vajzave, si dhe eliminimi i pengesave financiare dhe/ose kulturore në marrjen e shërbimeve të shëndetit fizik dhe mendor.

Kjo thirrje 3-vjeçare synon të përzgjedh organizatën jo-qeveritare, konsorciumin e organizatave apo organizatat, që do të bashkëpunojnë me MKRS-në, në zbatimin e projekteve, për të adresuar sfidat e sipërshënuara, duke ofruar shërbime cilësore, efektive dhe pa pagesë për të rinjtë që kanë probleme të shëndetit mendor dhe fizik.

Organizata ose organizatat duhet të ketë përvojë në fushën e edukimit dhe promovimit shëndetësor, si dhe në ofrimin e shërbimeve këshilluese dhe rehabilituese të nivelit profesional. Fushëveprimi i organizatës ose organizatave duhet të përfshijë të rinjtë nga të gjitha komunat e Kosovës, të moshave 15 - 29 vjeç. Synohet që organizatat të cilat do të mbështeten të kenë kapacitete profesionale dhe teknike, të jenë të organizuara mirë, të kenë vizion dhe mision përkrahjen dhe ofrimin e shërbimeve për të rinjtë, si dhe të kenë dëshmi që e dokumentojnë kontributin e tyre në zhvillimin e shëndetit të të rinjve në Kosovë.

Sipas përshkrimit të mësipërm, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit fton organizatat jo-qeveritare që të aplikojnë me projekt-propozimet e tyre për të zbatuar aktivitetet e Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor, të parapara në Strategjinë Shtetërore për Rini 2024-2032.

Organizatat jo-qeveritare në projekt-propozimet e tyre duhet të paraqesin:

1. Një projekt-propozim me plan të qartë narrativ dhe financiar për zbatimin e aktiviteteve lidhur me vetëdijesimin e të rinjve për dukuritë negative për prekin të rinjtë, si përdorimi i substancave narkotike, dhuna fizike dhe psikike, ngacmimet seksuale, delikuenca e të miturve, siguria kibernetike dhe ndikimi i saj në shëndetin mendor të të rinjve.
2. Të përshkruajnë qartë mënyrën e kontraktimit për ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe referimit të të rinjve në institucionet përkatëse shëndetësore profesionale, lidhur me problemet që kanë ata nga fushat e sipërpërmendura.
3. Hartëzimin e llojeve dhe efektivitetit të shërbimeve aktuale online nga fusha e shëndetit mendor, shëndetit seksual dhe riprodhues, varësisë, si dhe sigurisë fizike dhe kibernetike.
4. Ngritjen e kapaciteteve të personave të angazhuar në ofrimin e shërbimeve online, të cilat do të ofrohen përmes platformës elektronike <https://kosovoyouth.com/>
5. Të përcaktojnë qartë mbikëqyrjen dhe dokumentimin e shërbimeve të ofruara në mënyrë fizike dhe online përmes hartimit paraprak dhe prezantimit në projekt – propozim, të testeve para dhe pas trajnimit, përkatësisht para dhe pas ofrimit të shërbimit.
6. Të përcaktojnë qartë se si do të analizojnë testimet e grumbulluara nga të rinjtë, dhe të ofrojnë dokumentacionin për profesionistët, që do të analizojnë pyetësorët para dhe pas trajnimit ose punëtorisë. E njëjta vlen edhe për pyetësorët që do të publikohen online. Të dhënat duhet të prezantohen në mënyrë grafike dhe parashihet të jenë të publikuara në platformën online.
7. Të përcaktojnë aktivitetet përmes të cilave do të promovojnë shërbimet online për të rinjtë dhe numrin e të rinjve që synojnë të arrijnë.

Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:

Vlerësimi administrativ, gjatë të cilit proces analizohet dokumentacioni i dorëzuar nga aplikuesi dhe dokumentohet nëse është ofruar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara me këtë thirrje publike. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

Vlerësimi përmbajtësor, gjatë të cilit proces analizohen vetëm dokumentacionet e projekt-propozimeve të cilat e kanë kaluar fazën e vlerësimit administrativ. Gjatë kësaj faze komisioni analizon përmbajtjen cilësore të projekt-propozimit si vijon:

- Nëse aplikuesi është i profilizuar, apo ka përvojë paraprake në fushën edukimit dhe promovimit shëndetësor me të rinjtë, dhënien e shërbimeve të këshillimit dhe rehabilitimit të të rinjve me probleme të shëndetit fizik dhe mendor, sipas përkufizimit të mësipërm në pikën 1. të kësaj thirrje publike, bashkëpunimin me institucionet publike dhe private që ofrojnë shërbime këshillimi dhe referimi për të rinjtë me probleme të shëndetit fizik dhe mendor, nëse OJQ-të kanë zhvilluar aktivitete që kanë mbuluar gjithë territorin e Kosovës, kapacitetet menaxheriale, organizative dhe profesionale që posedojnë OJQ-të aplikuese, dhe dëshmitë e bashkëpunimit me sektorin privat.

- Nëse aplikuesi ka zbatuar parimet e qeverisjes së mirë në zbatimin e projekteve në vitet paraprake, dhe nuk ka pasur vërejtje ose dokumentim të mos zbatimit, përkatësisht mos raportimit të projekteve të financuara nga MKRS. Nuk pranohet asnjë OJQ që ka projekt të hapur në kohën e shpalljes së kësaj thirrje publike.

- Nëse aplikuesi ka paraparë zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të prezantuar në këtë thirrje publike
- Nëse aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit të dëshmuara me dokumentacionin përkatës;
- Nëse është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit janë ndarë në mënyrë të saktë, bashkë me një përshkrim të detyrave të punës për secilin anëtarë të ekipit;
- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike;
- Nëse aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;

Në rast të dështimit për të përmbushur vetëm një nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikimi do të konsiderohet i pa kompletuar, dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Aplikimi:

Projekt - propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e MKRS-së në ueb: www.mkrs-ks.org. Aplikuesit në këtë thirrje duhet të aplikojnë vetëm përmes postës elektronike në e-mail adresën: dep.rinia@gmail.com . Projekt-propozimet e shtypura në formë fizike nuk pranohen për shqyrtim.

Titulli që duhet shënuar në subjekt të emaili-it: Thirrja për Programin ‘Rehabilitimi për të Rinjtë’

Afati për aplikim:

Afati i fundit për aplikim përfundon me datën:

31 maj 2024, në ora 23:59.

Më shumë informacione rreth thirrje publike:

Të gjitha çështjet që ndërlidhen me këtë ftesë publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: mirushe.emini@rks-gov.net , jo më vonë se pesë ditë para mbylljes së ftesës publike.

Kush mund të aplikojë:

Organizatat jo-qeveritare apo konsorciumet e organizatave të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat janë të në gjendje të dokumentojnë përvojën e tyre në fushën e edukimit dhe promovimit shëndetësor, dhe/ose ofrimin e shërbimeve për të rinjtë që kanë probleme të shëndetit fizik dhe psikik, të përcaktuara në fillim të kësaj ftese publike në pikën 1., si dhe plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara me këtë thirrje.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- ✚ Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- ✚ Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;

- ✚ Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafit i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit, të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- ✚ Të ofroj dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- ✚ OJQ-ja duhet të ketë përmbushur detyrimet eventuale kontraktuale të nënshkuara me ofruesin e mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesit tjerë të mbështetjes financiare nga fondet publike vendore ose ndërkombëtare (të mos ketë avanse të hapura);

Kriteret e veçanta të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- ✓ Të dorëzoj brenda afatit të thirrjes projekt-propozimin, i cili ndër të tjera përmban; përshkrimin e qartë të qëllimit, objektivat e përkufizuara qartë nga pika 1. e kësaj thirrjeje publike, sikurse edhe objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhëna të tjera të hollësishme, sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike;
- ✓ Të dorëzojë Planin e Veprimit për 12-muaj, të zbërthyer në aktivitete, afate kohore, personat bartës dhe përgjegjës, dhe koston e paraparë për përmbushjen e aktiviteteve të projekt – propozimit, mbështetur në standardin mesatar të Republikës së Kosovës. Edhe pse përmes kësaj thirrjeje do të nënshkruhet marrëveshje 3-vjeçare, plani i veprimit duhet të dorëzohet vetëm për vitin e parë, ndërkaq dorëzohet edhe programi i plotë trevjeçar, që do të thotë për dy vite në vijim, aktivitetet dhe kostoja financiare duhet të jenë të përshkuara në mënyrë të përgjithshme.
- ✓ Projekt propozimi duhet të jetë i shoqëruar me propozim-buxhetin për periudhën 12 mujore, sipas formatit të përcaktuar në thirrjen publike dhe Udhëzuesit për zbatimin e Rregullores (MF) Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
- ✓ OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e edukimit dhe promovimit shëndetësor për rininë, dhe në ofrimin e shërbimeve të këshillimit dhe referimit në institucionet publike shëndetësore kur është e nevojshme, si dhe në ofrimin e shërbimeve këshilluese dhe rehabilituese të nivelit profesional.
- ✓ Të ofrojnë portfolion me dëshmi të aktiviteteve në fushën e edukimit dhe promovimit shëndetësorë për së paku 2 vitet e fundit;
- ✓ Të dorëzojë të dhëna për personelin e projektit, duke siguruar CV-të e tyre, diplomën që dëshmon përgatitjen për të ofruar shërbime këshillimi dhe rehabilitimi, certifikata mbështetëse për ngritje specifike profesionale në fushat ku synohet të jepen shërbimet, dëshmi shtesë për përvojën në hartim të pyetësorëve dhe dokumentacionit shtesë për vlerësimin cilësor të shërbimeve të ofruara në mënyrë fizike ose online, dëshmi për aftësi në kryerjen e analizave të hartëzimit dhe dokumentimit të shërbimeve, shkathtësi të dokumentuara teknologjike të personelit për menaxhim të ofrimit të shërbimeve online;
- ✓ Të integroj, buxhetoj dhe zbatoj në periudhën e zbatimit të projekt-propozimit, kontraktimin e një kompanie të pa varur për të zhvilluar Auditimin e jashtëm dhe Vlerësimin e ndikimit social dhe ekonomik të projekt-propozimit me të cilin aplikon;
- ✓ Buxheti duhet të jetë i përputhshëm me standardin mesatar të ofrimit të shërbimeve në Republikën e Kosovës, dhe MKRS ruan të drejtën që të hulumtoj tregun lidhur me çmimet e ofruara dhe të kërkoj zvogëlim të çmimeve në rastet kur ato janë të ekzagjeruara;

- ✓ Të prioritzoj dhënien e shërbimeve për të rinjtë që vërtetë kanë probleme të shëndetit fizik dhe mendor, dhe nuk kanë mundësi financiare ti sigurojnë ato, pavarësisht nëse jetojnë në qytetet kryesore ose në zona rurale, pavarësisht nëse i takojnë komunitet shumicë apo atyre jo shumicë, dhe pa dalim dallim etnie, feje dhe gjinie;
- ✓ Të dorëzoj një formë marrëveshjeje bazë në mes të ofruesit të shërbimit dhe të resë/riut që do të marrë shërbimin lidhur me të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë kohës së ofrimit të shërbimit, ku përfshihet edhe aprovimi me nënshkrim i të dy prindërve (ose kujdestarit/rve), për të rinjtë nën moshën 18 vjeç;

Dokumentacioni në kuadër të aplikimit:

1. Formulari i Aplikimit për projekt-propozim (Dokument i thirrjes publike), i cili duhet të përmbaj të dhëna të sakta të paraqitura sipas Kornizës Logjike të Hartimit të Projekt-Propozimeve për vitin e parë dhe aktivitetet e përgjithshme që parashihen për dy vitet vijuese;
2. Formulari i Propozim buxhetit (dokument i thirrjes publike), i cili duhet të përmbaj aktivitetet e vitit e parë të buxhetuara në përpikëri, ndërsa aktivitetet e 2 viteve të tjera duhet të jenë të përgjithshme;
3. Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë (Dokument i thirrjes publike);
4. Formular i deklaratës së partneritetit, nëse aplikohet (Dokument i thirrjes publike);
5. Forma e deklaratës së projekteve të financuara nga fondet publike në dy vitet e fundit (Dokument i thirrjes publike);
6. Certifikata e regjistrimit dhe certifikata e numrit fiskal e OJQ-së (lëshuar nga Departamenti i OJQ-ve, ATK);
7. Vërtetimi që nuk ka obligime financiare ndaj ATK (dokumenti i lëshuar nga ATK dorëzohet nga përfituesi me rastin e nënshkrimit të kontratës);
8. Përveç këtyre OJQ-ja duhet të dorëzoj edhe portfolion që përmbanë listën e projekteve, aktiviteteve dhe personave të punësuar në dy vitet e fundit (dokument që hartohet nga vetë OJQ aplikuese)

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë vetëm nëse i përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme, siç kërkohet në thirrjen publike dhe në dokumentacionin e thirrjes si në vijim, të formuluar me qartësi, dhe duke respektuar të gjithë rregullat e Kornizës Logjike të hartimit të projekt – propozimeve.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Programi do të zbatohet në periudhë prej 36 muajsh.

Projekt-propozimet që do të përzgjidhen për mbështetje nga Komisioni Vlerësues i themeluar për këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi për tri vite, pra duke filluar nga viti 2024.

Për aktivitetet e vitit e parë, duhet të ofrohet planifikimi i saktë i aktiviteteve dhe i buxhetit, sipas formularëve të bashkëngjitur në këtë thirrje, si dhe programi i plotë trevjeçar me aktivitete të përgjithshme dhe kosto.

Shkalla e mbështetjes:

Vlera totale e planifikuar për këtë kategori për tri (3) vite, është 150,000.00 Eur.

Vlera minimale e mbështetjes për një organizatë dhe për një vit do të jetë: 30,000.00 Eur, ndërsa vlera maksimale e mbështetjes për një organizatë dhe për një vit nuk mund të tejkaloj 50,000.00 Eur.

Vini re:

Në rast se asnjëra nga organizatat jo-qeveritare aplikuese, apo konsorciumi i organizatave në partneritet, nuk i plotësojnë kriteret e parapara, MKRS rezervon të drejtën e anulimit të thirrjes.

Nëse projekti përzgjidhet dhe financohet nga MKRS-ja, për qëllime të monitorimit është i obligueshëm informimi i Departamentit të Rinisë mbi zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projektit, së paku dy javë para realizimit të aktivitetit.

MKRS/Departamenti i Rinisë, ruan të drejtën që gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të projekt-propozimit të kërkoj dokumente shitesë për të dëshmuar cilësinë e zbatimit dhe/ose për çështjet e ndryshme sociale-juridike që mund të shfaqen, dhe të cilat nuk janë paraparë në këtë thirrje publike.

Nëse projekti përzgjidhet dhe financohet nga MKRS, organizata dhe të rinjtë që do të zbatojnë aktivitetet vullnetare në projekt duhet të regjistrohen në platformën për certifikimin e orëve vullnetare 'Kosovo Volunteers' apo KoVo.